



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.445/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kandidatit për Kryetar të Komunës në Mamushë, Arif Butuc nga radhët e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), me dega në Mamushë, paraqitur kundër komisionerëve nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) në Mamushë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Arif Butuc, Kandidat për Kryetar të Komunës në Mamushë nga radhët e subjektit politik KTAP, dega në Mamushë, me të cilën kërkohet që të ndërmeren veprime ligjore ndaj komisionerëve të subjektit politik KDTP në Mamushë, Nuhi Bayraktar dhe Idriz Mazreku, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Arif Butuc, Kandidat për Kryetar të Komunës së Mamushës nga radhët e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), me të cilën pretendon se me datë 22.10.2017 në orët e hershme të mëngjesit nga policia dhe prokuroria janë marrë në pyetje për vjedhje të votave komisionerët nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Patrisi (KDTP), Nuhi Bayraktar dhe Idriz Mazreku. Mëtej pretenduesi i ankesës thekson se komisioneri nga subjekti politik KDTP, Gani Mazreku ka kërcënuar komisionerin e subjektit të tyre politik, Mirat Bitici. Përveç kësaj ka theksuar se gjatë ditës së votimit përfaqësuesi i KQZ-së për Mamushë, nuk iu është mundësuar të kryejë detyrat e veta për shkak se në shkollën ku ka qenë Qendra e Votimit subjekti politik KDTP kishin formuar kampin dhe personat nga ky subjekt që kanë qëndruar në kamp kanë kërkuar informata nga votuesit të cilët edhe i kanë kërcënuar. Lidhur me këtë rast ka informuar përfaqësuesin e KQZ-së Nuhi Mazreku dhe Komandatin e Policisë Enis Orqusha por të njëjtit nuk kanë ndërmarrë asgjë. Mëtej pretendohet se gjatë votimit në këtë Qendër të Votimit ka pasur vjedhje të votave, dhe është votuar në emër të personave të vdekur si dhe nga Turqia kishte ardhur Sefki Ozen me një grup të paguar nga subjekti politik KDTP me qëllim të përkrahjes të këtij subjekti pasi që ata nuk kanë qenë të regjistruar në lista.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Kosova Demokratik Turk Patrisi (KDTP) të datës 24.10.2017 thekson se pretendimet e kandidatit për kryetar të KTAP-së Arif Butuc në ankesën ZL.Anr.445/2017 janë të paqarta dhe të pabazuara sepse me 22 Tetor 2017 janë zhvilluar votime nën organizimin e KQZ-së dhe janë monitoruar nga ana e shumë subjekteve vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar nga ana e të cilëve nuk është shënuar asnjë parregullsi. Mëtej në përgjigje theksohet se në procesverbalet të KVV-ve e 5 kutive në Mamushë gjithashtu nuk ka shënime për pretendimet e parashtruara në ankesë me të cilën edhe përfaqësuesit e KTAP-së ishin anëtarë të KVV-ve.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga parashtresa e datës 24.10.2017 e Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), paneli konstatoi se në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), të gjitha materialet sensitive dhe josensitive, të cilat dorëzohen në KVV dhe KKZ-të do t'i verifikoj gjatë ditëve në vazhdim dhe çdo parregullsi edhe në rastet konkrete që janë objekt ankimor në PZAP, do të auditohen dhe korrigjohen dhe për çdo parregullsi QNR-ja i rekomandon KQZ-së, hapat e mëtejshme për vendimmarrje. Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me punën e ZLKZ-së, Nuhi Mazrek përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur deklaratën e ZLKZ-së në Mamushë Nuhi Mazrek.

Me deklaratën Nuhi Mazrek-ZLKZ, në Komunën e Mamushës të datës 24.10.2017, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme sespe nuk ka asnjë informat lidhur me parregullsitë e pretenduara në ankesë. Në deklaratën e tij thekson se lidhur me parregullësit që ndodhin në Qendrën e Votimit kryesuesi e informon Menaxherin e Qendrës së Votimit e pastaj menaxheri e informon policinë. Mëtej deklaroi se në pesë vendvotime Kryesuesve iu kanë dorëzuar lista e telefonave që mund ti lajmrojnë rastet. Nuk janë të vërteta pretendimet e ankuesit përkitazi me formimin e kampit dhe kërcënimet e bëra nga subjekti politik KDTP, pasi që policia ka larguar çdo person afër Qendrës së Votimit (QV).

Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës 24.10.2017, paneli konstatoi se pretendimet në ankesë janë të pabazuara lidhur me formimin e kampit dhe kërcënimin e votuesve. Në polici ky rast është raportuar dhe nga policia menjëherë janë ndërmarr masa të parapara ligjore dhe njerëzit që kanë qenë pranë lokalit afër Qendrës së Votimit i kanë larguar, ndërsa në lokal kanë qëndruar vetëm personat që kanë qenë duke u shërbyer dhe nuk janë identifikuar që i përkasin ndonjë subjekti politik. Po ashtu nga raporti është konstatuar se në ditën e votimit policia ka qenë prezent në Qendrën e Votimit të cekur në ankesë dhe nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi dhe se nuk ka paur ankesa nga ndonjë qytetar apo vëzhgues, në përjashtim të një rasti ku shkelësit e supozuar janë dërguar në polici.

Ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij se subjekti politik KDTP, ka bërë shkelje nga dispozitë ligjore të nenit 34 par.1 dhe 2 të LZP-së, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat e dhe ka vërtetuar në mënyrë të padyshimt, se pretendimet ankimore janë pabazuar në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë nga prashtruesi i ankesës, andaj ankesa e ankuesit u refuzua si e pabazuar në kuptim të nenin 118 të LZP-së.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.445/2017 më datën 25.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.